Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

03.04.2023, Prishtinë,
Ref:15.02.2023\1359-2023

Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj ankesës së Gjon Karrica kundër Kosovarja

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të mbajtur më 28 mars 2023, shqyrtoi ankesën e dërguar nga Gjon Karrica kundër Kosovarja lidhur me publikimin e shkrimit me titull ”Gjon Karrica nuk kthehet në “Big Brother VIP Kosova” dhe mori këtë

V E N D I M

- Ankesa miratohet.

A R S Y E T I M I

Media ka publikuar një lajm me titull ”Gjon Karrica nuk kthehet në “Big Brother VIP Kosova”, me pretendimin se artikulli bie në kundërshtim me kapitullin VII (privatësia) të Kodit të Mediave.

Lajmi është shkruar në gazetë online dhe objekt i kësaj ankese është teksti i shkruar, e që rrjedhimisht ankesa është e afatshme.

Pas leximit të ankesës KMShK gjen se ankesa është e bazuar. Pra, miratohet.

KMShK në lidhje çështjen e privatësisë gjen se shkrimi ndërhyn në jetën private ankuesit, pasi që bëhet fjalë për raportimin e diagnozës së pretenduar pas daljes së tij nga “reality show”. Edhe pse ankuesi është figurë publike, gjurmimi në jetën e tij personale dhe aq më tepër në ndonjë sëmundje apo shpërfaqja e saj në publik, konsiderohet shkelje e të dhënave personale dhe ndërhyrje në privatësi. Nëse pala nuk dëshiron ta bëjë publike sëmundjen e tij/saj, atëherë as media nuk ka të drejtë të raportojë dhe të gjurmojë atë, edhe nëse pala është person i rëndësishëm.

Andaj, KMShK vendos që ankesa të miratohet.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës